



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2609/Prot

Tiranë më 18.10 2022

3

VENDIM

Nr. 50, datë 14/10/ 2022

**“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 PËR
UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të:

- Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,nenin 49,pika1 ,gërma c);
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjit nr.115/2021, date 26.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” ;
- Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Ligjit nr.10.296 datë 08.07.2010 “Për Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Vendimit Senatit Akademik të UT-së Nr 25 datë 30.09.2022 “Për miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Universitetin e Tiranës”;

Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 14/10/ 2022 mori në shqyrtim dhe diskutoi materialin e paraqitur nga Senati Akademik i UT-së me shkresen nr.2609/2, datë 30.09.2022, “Përcillet Vendimi i Senatit Akademik të UT-së nr.25 datë 30.09.2022”. Bordi i Administrimit duke konstatuar se në këtë material janë marrë në konsideratë kërkesat e njësive shpenzuese,

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 në përputhje me tavanet ligjore të shpenzimeve, sipas formularëve të paraqitur.
2. Autorizohet Administratori i UT-së dhe strukturat përkatëse në Rektorat-in e UT-së, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

